



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 38, datë 20.12.2019

**Për miratimin e termave të referencës dhe kritereve të përzgjedhjes të Audituesit të Brendshëm të Specializuar, për auditimin e brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin financiar 2020**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, të nenit 52, pika 1, shkronja “j” dhe të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të kreut X të Ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 17, pika 1 dhe të nenit 18 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

V E N D O S I:

1. Të miratojë termat e referencës dhe kriteret e përzgjedhjes të audituesit të brendshëm të specializuar, për auditimin e brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin financiar 2020, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar